

Zyra e Arsimit të Posaçëm Informacioni rreth ankesës Paketa dhe formulari

Mars 2016

I nderuar (prind/kujdestar/ankues):

Ju faleminderit që kontaktuat me Zyrën e Arsimit të Posaçëm (Bureau of Special Education (BSE)) duke na dhënë mundësinë t'ju ndihmojmë në këtë çështje. Ju lutemi, shqyrtoni me kujdes materialet shoqëruese. Nëse keni pyetje, mund të kontaktoni lirisht te ConsultLine në nr. 1-800-879-2301 ose te BSE në nr. (717) 783-6913.

Procesi i ankimit fillon kur BSE merr një ankesë të nënshkruar dhe të plotësuar. BSE duhet të përfundojë hetimin dhe të nxjerrë një raport hetimi ankesë (Complaint Investigation Report (CIR)), brenda 60 ditëve. Nëse evidentohen shkelje të kërkesave shtetërore ose federale, Agjencia Arsimore Vendore (Local Educational Agency (LEA)), ku përfshihen njësia ndërmjetëse, rrethi shkollor, shkolla private, zyra rajonale (Philadelphia), APS etj. do të udhëzohet që të korrigjoj mospajtimin.

Çdo ankesë i caktohet një konsulenti të arsimit të posaçëm (Special Education Adviser (SEA)) të punësuar nga BSE.

- Konsulenti do t'ju kontaktojë me telefon për të sqaruar problemet e ankesës. Konsulentin mund ta takoni personalisht në një ambient publik gjatë orarit të zakonshëm të punës.
- Konsulenti do t'ju kërkojë t'i jepni emrin ose emrat e të tjerëve që mund të kenë dijeni për faktet e ankesës dhe do të intervistojë një numër të arsyeshëm prej tyre para se të nxirret raporti. (Opsionale)
- Një letër konfirmimi do t'ju dërgohet me postë për të verifikuar problemet e ankesës.
- Nëse problemet e ngritura nuk janë në juridiksionin e BSE-së, do të merrni një letër që deklaron diçka të tillë. Do t'ju jepet informacion kontakti për agjencitë e tjera që mund t'ju vijjnë në ndihmë.
- Konsulenti mund të kryejë një hetim aty për aty, pranë LEA-s, për të shqyrtuar të dhënat përkatëse dhe për të intervistuar personelin.
- Mund të jepni informacione shtesë qoftë me gojë, qoftë me shkrim, përpara CIR përfundimtar.
- Konsulenti do të analizojë në vijim faktet dhe do të përpilojë CIR me shkrim.
- Konsulenti do t'ia përcjellë CIR shefit të divizionit për shqyrtim dhe rishikim.
- CIR do të nxirret pasi të miratohet nga shefi i divizionit.

Secila palë mund të kërkojë rivlerësimin e gjetjeve të CIR, nëse ka informacione që nuk dihen në kohën e CIR, që do mund ta ndryshonin përfundimin apo masën korrigjuese; ose nëse ka mospajtime midis përfundimit të CIR dhe masës korrigjuese. BSE duhet të marrë

kërkesën për rivlerësim jo më vonë se 10 ditë pas datës së CIR. Me marrjen e raportit, shefi i divizionit duhet ta shqyrtojë dhe të vendosë nëse duhet të ndryshojë CIR apo nëse duhet të anulojë kërkesën për rivlerësim.

Palët mund ta zgjidhin ankesën në formë të pavarur. Nëse palët i zgjidhin problemet, LEA do të dorëzojë një konfirmim me shkrim duke marrë dhe nënshkrimin e ankuesit. BSE i lëshon ankuesit dhe LEA-s një letër zgjidhjeje për mbylljen e ankesës.

Ankuesi mund të zgjedhë gjithashtu ta tërheqë ankesën. Konsulenti do të kontaktojë ankuesin dhe do të kërkojë njoftim formal me letër dhe BSE do të lëshojë një konfirmim ndaj ankuesit nëpërmjet letrës së tërheqjes.

Palët mund të hyjnë në proces ndërmjetësimi në çdo kohë. Nëse palët hyjnë në ndërmjetësim apo në forma të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, p.sh. ndihmë nga programi i personalizuar arsimor (Individualized Education Program (IEP)), afati për hetimin e ankimit mund të shtyhet edhe përtej 60 ditëve.

Baza rregullatore

Informacion rreth ankesës – Sipas rregullores federale (Federal Regulation) (34 CFR §300.153) ka disa elemente të detyrueshme për të dorëzuar një ankesë. Vijon më poshtë rregullorja.

§300.153 Dorëzimi i ankesës.

- (a) Një organizatë apo individ mund të dorëzojë një ankesë të vetme me shkrim dhe të nënshkruar sipas procedurave të përshkruara në §§300.151 deri në 300.152.
- (b) Ankesa duhet të përmbajë:
 - (1) Një deklaratë se agjencia publike ka shkelur një kërkesë sipas pjesës B të ligjit ose të kësaj pjese;
 - (2) Faktet mbi të cilat ngrihet deklarata;
 - (3) Nënshkrimin dhe informacionin e kontaktit të ankuesit; dhe
 - (4) Nëse pretendohen shkelje në lidhje me një fëmijë të caktuar:
 - (i) Emrin dhe adresën e vendbanimit të fëmijës;
 - (ii) Emrin e shkollës që ndjek fëmija;
 - (iii) Në rastin e një fëmije apo të riu të pastrehë (sipas kuptimit të paragrafit 725(2) të ligjit Për asistencë ndaj të pastrehëve, Mak-Kinej-Vento (McKinney-Vento Homeless Assistance Act) (42 U.S.C. 11434 a (2)), informacionin e disponueshëm të kontaktit për fëmijën dhe emrin e shkollës që ndjek fëmija;
 - (iv) Një përshkrim të natyrës së problemit të fëmijës, duke përfshirë fakte në lidhje me problemin; dhe
 - (v) Një zgjidhje të sugjeruar të problemit për sa ky njihet dhe për sa ka mundësi pala në kohën e dorëzimit të ankesës.
- (c) Ankesa duhet të pretendojë për shkelje që ka ndodhur jo më shumë se një vit përpara datës së marrjes së ankesës në përputhje me §300.151.
- (d) Pala që dorëzon ankesën duhet t'i përcjellë një kopje LEA-s, ose agjencisë publike që i shërben fëmijës, duke ia dorëzuar njëherësh ankesën konsulentit të arsimit të posaçëm.

Dorëzimi nga një palë e tretë – Njoftimi i kushteve të konfidencialitetit

Nëse ankesën e dorëzon një person tjetër, përveç prindit apo kujdestarit, ankuesi do të marrë një letër nga konsulenti i arsimit të posaçëm ku deklarohet se, pa lejen e prindërve, për lëshimin e informacioneve konfidenciale, BSE nuk mund t'i përgjigjet drejtpërdrejt atyre në lidhje me ankesën. Por, BSE do të kryejë një hetim, do të përgatisë një CIR të gjetjeve dhe do t'ia përcjellë gjetjet drejtpërdrejt prindit dhe LEA-s.

Ndryshime të rëndësishme në rregulloret federale (ankesa)

Nëse keni dorëzuar ankesa më parë, duhet të dini se ka pasur ndryshime të konsiderueshme në rregulloret e reja federale që vlejnë për procesin e ankimimit. Kodi i rregulloreve federale (Code of Federal Regulations (CFR)) 34 pjesa B ka sjellë disa ndryshime të rëndësishme në procesin e ankimimit:

1. Ankuesi duhet të nënshkruajë ankesat përpara se BSE të hetojë pretendimin. Ndaj, ne nuk kemi më mundësi të marrim ankesa të dërguara me email.
2. Ankuesit i kërkohet me rregullore të përcjellë te LEA një kopje të ankesës.
3. Ankuesi duhet të sugjerojë një zgjidhje ndaj problemit.
4. Agjencia publike ka mundësinë të përgjigjet duke ofruar një sugjerim për zgjidhjen e ankesës.
5. Prindit që ka dorëzuar ankesën dhe agjencisë publike u jepet mundësia që të përfshihen vullnetarisht në ndërmjetësim.
6. Ankuesi merr një kopje të njoftimit të masave procedurale (Procedural Safeguards Notice) nga LEA kur ankuesi dorëzon ankesë për herë të parë gjatë vitit shkollor.

Formular ankese

Mund të bëni kopje të këtij formulari, të përdorni fletë plotësuese ose t'i telefononi ConsultLine në nr. 1-800-879-2301, ose Zyrës së Arsimit të Posaçëm (BSE) në nr. 717-783-6913 për kopje të tjera.

Forma ime e preferuar e kontaktit nga konsulenti i caktuar për këtë ankesë do të ishte:

- Me telefon (jepni numrin):**
Ora më e përshtatshme për t'ju telefonuar gjatë orarit të zakonshëm të punës:
- Me email (jepni adresën e emailit):**
- Personalisht në një ambient publik gjatë orarit të zakonshëm të punës.** Me shumë mundësi vendi do të jetë shkollë apo ndërtesë njësie ndërmjetëse ku është i mundur publikimi i dokumenteve.

A po e dorëzoni ankesën për llogari të një fëmije të caktuar? Po Jo

Jepni informacionin e kontaktit, marrëdhënien me fëmijën dhe nënshkrimin tuaj.

Emri:

Adresa:

Numri i telefonit:

Shtëpi:

Punë:

Celular:

Email:

Marrëdhënia me fëmijën ose fëmijët:

- Prind Avokat Jurist Tjetër

Emri dhe adresa e vendbanimit të fëmijës, shkolla dhe rrethi shkollor.

Emri i fëmijës:

Data e lindjes:

Adresa:

A është fëmija aktualisht në shkollë? Po Jo

Nëse po, ku kryhet programi aktual i fëmijës:

Në ndërtesën e shkollës:

Në rrethin shkollor:

Në shkollë private:

Plotësojeni *vetëm* nëse ankesa po bëhet për llogari të një fëmije apo të riu të pastrehë.

Personi i kontaktit:

Telefoni:

A ka ndodhur shkelja gjatë vitit të kaluar? Nëse po, në cilën apo rreth cilës datë?

Data:

Për të qartësuar pohimet e mia, do të dëshiroja që konsulenti të intervistojë personin ose personat e mëposhtëm. (Opsionale)

Emri	Profesioni/titulli	Numri i telefonit/adresa e emailit

Jepni një deklaratë rreth shkeljes apo problemit që mendoni se ka ndodhur. Jepni dhe një përshkrim rreth natyrës së problemit.

Përmendni faktet që mbështesin deklaratën tuaj.

Në maksimumin e njohurive tuaja, sugjeroni një zgjidhje për këtë problem.

Kjo ankesë duhet nënshkruar për hetim nga BSE. Duhet gjithashtu të dërgoni një kopje të kësaj ankese në Agjencinë Arsimore Vendore (LEA). Me nënshkrimin tuaj më poshtë, i tregoni BSE se keni dorëzuar një kopje të ankesës pranë LEA-s.

Nënshkrimi

Data

Ju lutemi, dërgoni këtë formular te:

PDE/BSE

Division of Compliance Monitoring and Planning

333 Market Street, 7th Floor

Harrisburg, PA 17126-0333

ConsultLine – procesi i zgjidhjes me telefonatë (Call Resolution Process (CRP))

Inicialet

Data